

VENDIM
Nr.544, datë 27.7.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE QË RIMBURSOHEN NGA INSTITUTI I
SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE MASËN E MBULIMIT TË
ÇMIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 15 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Masa e mbulimit të çmimeve të barnave të listës së barnave që rimbursohen sipas klasifikimit ATC, të jetë në masën 50 (pesëdhjetë) për qind deri në 100 (njëqind) për qind, sipas grupeve terapeutike dhe barnave të pasqyrës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Masa e mbulimit të çmimit të barnave për alternativën e parë në listën e barnave të rimbursueshme për kategorinë e pensionistëve, të jetë në masën 100 (njëqind) për qind.

4. Miratimin e marzheve të diferencuara të tregtimit, përkatësisht në masën 10 (dhjetë) për qind për tregtimin me shumicë dhe 26 (njëzet e gjashtë) për qind për tregtimin me pakicë për barnat e listës së barnave të rimbursueshme, si dhe marzhet e diferencuara të tregtimit me shumicë e pakicë të disa barnave të listës, sipas pasqyrës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 2011, miratuar për Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, si dhe të ardhurat tepër, të realizuara gjatë vitit 2010 nga ky Institut.

6. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor të përcaktojë kufizimet në përdorimin, sasinë dhe kohëzgjatjen e trajtimit me barnat e kësaj liste.

7. Vendimi nr.401, datë 1.6.2011 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha